

BSPK-në e vizitoi delegacioni i Këshillit Ekonomiko Social Evropian (EESC)



Prishtinë, 31 janar 2012 -Më 30 dhe 31 janar 2012, Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës e ka vizituar një delegacion dhjetë anëtarësh i **Këshillit Ekonomiko Social (EESC)**. Ky delegacion kryesohej nga kryetari i sektorit për marrëdhënie të jashtme të EESC z. Sandy Boyle, Të pranishëm ishin edhe Pierre- Jean Coulon, anëtarë i EESC nga Sindikatat, Cveto Stantic president i Grupit të Kontaktit për Ballkanin Perëndimor si dhe nënkryetar në EESC i grupit të Punëdhënësve, Tomas Jazhinski anëtarë i EESC dhe përfaqësuese i grupit të punëtorëve, z.Tiina Benredjem, zyrtare për politika në zyrën e Komisionit Evropian për Kosovën.

Delegacioni u takua me kryetarin e BSPK-së Haxhi Arifi me kryetarin e Federatës Sindikale të Shëndetësisë Blerim Sylja, si dhe Dafina Mehaj zyrtare për marrëdhënie me jashtë. Udhëheqja e BSPK-së i njoftoi ata për situatën momentale të Dialogut Social në Kosovë dhe gjendjen aktuale të punëtorisë kosovare në përgjithësi.

Ky takim është i një rëndësie të veçante për BSPK-në, sepse për herë të parë në Kosovë vjen një delegacion i EESC me një përbërje kaq të madhe dhe me një interesim të madh për zhvillimet sociale në Kosovë.

Më 31 janar delegacioni i EESC do të mbajë takim të hapur për shoqërinë civile në Kosovë, ku do të flitet për aspektet ligjore, statutin, tatimet, organizatat e mikro kredive për rolin e shoqërisë civile në draftimin e legjislacionit- rregullat e reja të proceduarve të Qeverisë si dhe çështje tjera, ku njëherit edhe BSPK-ja do të jetë e pranishme . Ne seancën e dytë do të flitet për Kuvendin e Kosovës dhe bashkëpunimin tij me shoqërinë civile dhe ne seancën e tretë do të diskutohet për Këshillin Nacional të Integritimit Evropian dhe përfshirjen e shoqërisë civile në këtë Këshill. ***